



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 97, Datë 23.04.2018

MBI

**MIRATIMIN E TARIFËS SË TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR NGA  
SHOQËRIA ALBGAZ SH.A., PËR VITIN 2018.**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; neneve 13 pika 2 dhe 33 të ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, si dhe nenit 19 të “Rregullave të Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 23.04.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Çmimeve dhe Tarifave në lidhje me “Miratimin e Tarifës të Transmetimit të Gazit Natyror për vitin 2018”,

**Konstatoi se :**

- Shoqëria ALBGAZ sh.a. me shkresën nr. 85/1 Prot., datë 03.01.2018, protokolluar në ERE me nr. 13 Prot., datë 04.01.2018, ka paraqitur kërkesën për “Miratimin e tarifës së Transmetimit të Gazit Natyror“, sipas materialit që shoqëria i ka bashkangjitur kësaj kërkesë.
- ERE me vendimin, nr. 90, datë 07.06.2017, ka miratuar tarifën e përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “ALBGAZ” sh.a. për periudhën 05.01.2017 – 20.09.2017”, i ndryshuar me Vendimin nr. 155, datë 28.09.2017 dhe me Vendimin nr. 14 datë 10.01.2018.
- ERE me Vendimin nr. 178, datë 08.11.2017, ka miratuar Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror.
- ERE me vendimin e bordit nr. 20, datë 19.01.2018 vendosi “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria ALBGAZ sh.a, për vitin 2018”.
- ERE pas marrjes së vendimit nr. 20, datë 19.01.2018 “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria ALBGAZ sh.a, për vitin 2018”, ka vijuar me dërgimin e këtij vendimi për publikim në mediat e shkruara kombëtare, si dhe në faqen e saj të internetit dhe palëve të interesuara për marrje mendimi. Në përfundim ka rezultuar se asnjë palë nuk ka shprehur opinionin/komente në lidhje me këtë aplikim.
- ERE, me anë të shkresës 13/1 Prot, datë 26.01.2018, pas analizës së kryer këtij aplikimi i kërkoi nga shoqëria “ALBGAZ” sh.a. dokumentacion plotësues lidhur me çështjet e argumentuara në këtë kërkesë.

- Shoqëria “ALBGAZ” sh.a. me anë të shkresës nr.13/3, Prot., datë 20.02.2018, ktheu përgjigje në lidhje me kërkesat për informacion nga ana e Entit Rregullator të Energjisë.
- ERE pas analizës së përgjigjeve të dërguara nga shoqëria, në datë 20.03.2018, organizoi një seancë dëgjimore teknike me përfaqësuesit e “ALBGAZ” sh.a. dhe “Albpetrol” sh.a., Në seancën dëgjimore teknike u diskutuan çështjet e paqartësuara, në lidhje me analizën e kryer të aplikimit në vetvete, përgjigjeve shtesë të dërguara nga shoqëria si dhe trajtimet teorike të Metodologjisë përkatëse për aktivitetin e transmetimit të gazit natyror. Në përfundim të seancës, u ra dakord që të dërgoheshin në ERE sqarime të mëtejshme për komponentët e ndyshëm të të ardhurave të kërkuara për tarifën e transmetimit të gazit natyror për vitin 2018.
- ERE në datën 30.03.2018, organizoi një tjetër seancë dëgjimore për të gjitha palët e interesuara në këtë proces, pas dërgimit të shpjegimeve shtesë mbi aplikimin për tarifën e transmetimit të gazit natyror për vitin 2018, nga ana e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE,

**Vendosi:**

1. Miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a, për vitin 2018 prej 28 lekë/m<sup>3</sup> ose 2.6457 lekë/kWh.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumtorit të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**